

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikafloor®-3 QuartzTop GR

FORCUES ME NGJYRË DHE ME BAZË MINERALE PËR DYSHEMETË PREJ BETONI



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikafloor®-3 QuartzTop GR është një forcues prej një përbërësi, i përzierë paraprakisht, i ngjyrosur dhe mineral për dyshemetë prej betoni. Përbëhet nga çimento, agregate posaçërisht të përzgjedhura mineralesh kuarci dhe aditivë.

PËRDORIMET

Sikafloor®-3 QuartzTop GR duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

- Sikafloor®-3 QuartzTop GR kontribuon në formimin e dyshemeve monolitike prej betoni, rezistuese ndaj konsumimit. Kur spërkatet dhe inkorporohet në dyshemetë prej betoni të freskët, formon një sipërfaqe të lëmuar dhe rezistente ndaj konsumimit.
- Përdorime tipike në magazina, fabrika, qendra tregtare, kudo që dyshemeja me rezistencë ndaj konsumimit dhe abrazionit është kërkesa kryesore.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Rezistencë ndaj përplasjeve
- Forcues i sipërfaqes me kosto efikase
- Kundër pluhurit
- Aplikim i shpejtë
- Rezistencë e shtuar ndaj vajrave dhe grasos
- Përzjerje e përbërësve në fabrikë, me cilësi të garantuar të produktit përfundimtar
- Pastrim i lehtë i sipërfaqes përfundimtare
- Shumëllojshmëri ngjyrash

MIRATIME / STANDARDE

Produkt me bazë çimentoje për shtrimin e dyshemeve sipas EN 13813:2002, Deklarata e Performancës 95950231 dhe mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Agregate kuarci të përziera me çimento të modifikuar me minerale të posaçme.
Ambalazhi	Thes 25 kg
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur / Gri Ngjyra të tjera me porosi
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, në kushte të freskëta dhe të thata në temperatura midis +5°C dhe +30°C. Të mbrohet nga lagështia.
Dendësi vëllimore (bulk density)	1.65 ± 0.10 kg/lit (në +20°C)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj abrazionit	AR1 (metoda BCA, EN13892-4)
----------------------------	-----------------------------

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit

Përdorni produktet që përmenden më poshtë siç tregohet në skedat teknike përkatëse:

Nënshtresa

Pllakë betoni të freskët (lexo më poshtë "Cilësia e nënshtresës")

Forcuesi

Aplikim manual ose me makineri i Sikafloor®-3 QuartzTop GR. Nivelimi i sipërfaqes me helikopter ose pajisje niveluese me lazer. Përpunim përfundimtar me helikopter.

Përbërësi për trajtimin

Sikafloor® ProSeal-22, Sikafloor® ProSeal-W, Antisol® S.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi

~4- 5 kg/m²

Temperatura e mjedisit

+5°C min. / +35°C max.

Lagështia relative e ajrit

min. 30% lagështi relative / max. 90% lagështi relative

Temperatura e nënshtresës

+5°C min. / +30°C max.

Produkti i aplikuar gati për përdorim

Temperatura e nënshtresës	+10°C	+20°C	+30°C
Qarkullimi i këmbësorëve	~ 18 orë	~ 12 orë	~ 8 orë

Vlerat e mësipërme varen nga afati kohor që i nevojitet betonit për të fituar rezistencat e tij të projektuara për funksionim dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të mjedisit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Betoni që dorëzohet tek vepra duhet të ketë cilësi të qëndrueshme dhe të plotësojë kërkesat e EN 206-1. Karakteristikat e betonit specifikohen nga klasa e rezistencës së tij me bazë studimin statik dhe rekomandimet e përgjithshme për formulimin e miksit të betonit. Klasat tipike të betonit për dysheme të armuara betoni janë C20/25 (B25) ose C25/30 (B30), dhe në raste të veçanta C30/37 (B35).

Këshillohet përdorimi i superplastifikatorëve Sikament® ose Sika® ViscoCrete® për të siguruar cilësinë optimale të betonit dhe kudo që përdoren fibra, sigurohuni për shpërndarjen e barabartë të tyre brenda miksit.

Betoni me ajër të bllokuar nuk është një nënshtresë e përshtatshme për aplikim e forcuesve të sipërfaqes.

APLIKIMI

Aplikim mekanik - Spërkatje automatike në kombinim me pajisje niveluese me lazer: Spërkatni 4-5kg/m² në një aplikim menjëherë pas nivelimit dhe lejoni që pllaka të arrijë në nivelin e papërshkueshmërisë. Pastaj përdorni helikopterin vazhdimisht derisa të përftohet sipërfaqja përfundimtare.

Aplikim manual: Në varësi të kushteve, largoni rrjedhjet nga sipërfaqja. Spërkatni Sikafloor®-3

QuartzTop GR në betonin e niveluar në 2 faza (faza e parë: ~3 kg/m²; faza e dytë: ~2 kg/m²). Kushtoni kujdes aplikimit të produktit pa krijuar rrudhosje etj. mbi sipërfaqen e betonit. Spërkatja e pakujdesshme e Sikafloor®-3 QuartzTop GR ose më shumë se 2 metra larg nga pika e spërkatjes do të reduktojë konsistencën e finiturës.

Mos shtoni ujë gjatë aplikimit.

Finitura përfundimtare për mbylljen e poreve dhe largimin e rrudhosjeve mund të arrihet manualisht ose me helikopter.

METODA E MATURIMIT

Trajtoni dhe izoloni Sikafloor®-3 QuartzTop GR menjëherë pas përdorimit me cilindo nga produktet të serisë Sikafloor® ProSeal ose Sika® Antisol® S. (referohuni në skedat teknike përkatëse).

Izoluesit forcojnë sipërfaqen, pakësojnë formimin e pluhurit dhe reduktojnë përthithjen e lëngjeve.

Fugat:

Pas përfundimit të punimeve dhe modifikimit të fugave, pastroni pa u vonuar çdo papastërti, vaj, graso dhe materiale të shkrifëta. Fugat mund të mbushen me Sikaflex® PRO-3 ose me izolues tjetër të posaçëm Sikaflex® në përputhje me kërkesat e projektimit të dyshemesë.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Heqja e mbetjeve të freskëta nga veglat, mjetet dhe

pajisja e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / maturuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

MIRËMBAJTJA

PASTRIMI

Për të ruajtur paraqitjen e dyshemesë pas aplikimit, duhet të largohen menjëherë të gjitha derdhjet dhe dyshemeja duhet të pastrohet rregullisht me furça rrotulluese, përdah mekanik, pastrues me presion të lartë, teknika pastrimi dhe fshesë vakuumi, etj. duke përdorur detergjent dhe dyll të përshtatshëm. Për më shumë informacione, ju lutemi referohuni tek Method Statement për pastrimin dhe mirëmbajtjen e forcuesve Sikafloor®.

KUFIZIME

- Kurrë mos shtoni ujë mbi sipërfaqen ku është aplikuar forcuesi.
- Sikafloor®-3 QuartzTop GR rezulton në forcimin e sipërfaqes së pllakës më shpejtë se zakonisht. Duhet të bëhet prerje e kujdesshme përgjatë skajeve ku do të bëhet dredhja e pllakave të tjera ngjitur.
- Koha e aplikimit për produktet e forcimit të dyshemesë ndikohet nga çdo faktor i cili ndikon në vendosjen e betonit, dhe për pasojë mund të variojë ndjeshëm, në varësi të kushteve mbizotëruese. Për aplikim mekanik me pajisje automatike dhe pajisje nivelimi me lazer, përhapja mund të nisë pothuajse menjëherë pasi betoni është niveluar për të lejuar hidratimin e forcuesit. Inkorporimi i tij tek betoni me helikopter mund të fillojë sapo dyshemeja të mund të mbartë peshën e helikopterit. Për aplikim manual, forcuesi duhet të përhapet sapo mund të shkelet mbi dysheme, pa lënë gjurmë më të thellë se 3 - 5mm. Kontrolli periodik i gjendjes dhe zhvillimit të betonit do të përcaktojë kohëzgjatjen e saktë për secilën fazë dhe sekuencë të aplikimit.
- Aplikimi i pluhurit të forcuesit nuk duhet të bëhet në erë të fortë apo në kushte të thata.
- Mos përdorni beton tek i cili është zëvendësuar një pjesë e çimentos me tym silici, pasi miksi bëhet më e ngjitshëm dhe më pak i punueshëm.
- Variacionet në karakteristikat e betonit si përmbajtja e ujit dhe çimentos mund të çojnë në ndryshime të lehta të ngjyrës.
- Forcuesit e dyshemeve ofrojnë një finiturë dyshemeje me pak variacion të ngjyrës për shkak të ndryshueshmërisë natyrale të betonit mbi të cilin aplikohen.
- Që të sigurohet konsistenca optimale e ngjyrës, është thelbësore që punimet e shtrimit të dyshemesë të jenë sa më të pastra dhe sa më të mbrojtura nga kushtet e mjedisit.
- Ndryshimi në ngjyrë gjatë periudhës së tharjes është normal për këtë sistem dhe pritjet.
- Duhet bërë çdo përpjekje për të siguruar një aplikim të homogjen të Sikafloor®-3 QuartzTop GR. Është thelbësor aplikimi në kohën e duhur dhe me teknika të sakta.
- Në lagështi relative të ulët (nën 40%), mund të shfaqet efloreshencë mbi sipërfaqe.

- Në lagështi relative të lartë (mbi 80%) dhe temperaturë të ulët, mund të shfaqen bulëza, maturim dhe ngurtësim i ngadaltë dhe punimet e mëtejshme të finiturës të zgjaten.
- Referohuni në Method Statement për detaje aplikimi.
- Fugat e tkurrjes duhet të krijohen brenda dy ditëve. Fugat e zgjerimit duhet të formohen edhe në sipërfaqen përfundimtare të dyshemesë.
- Si pasojë e përpunimit të përsëritur me helikopter, i cili shkakton tension mbi sipërfaqe, mund të shfaqen plasaritje të holla tek dyshemeja. Ky fakt i dukshëm është tipik për të gjitha sipërfaqet prej betoni të përpunuara me helikopter dhe nuk ndikon negativisht në performancën e dyshemesë.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikafloor®-3 QuartzTop GR
Mars 2019, Botimi 03.01
020815010030000054

Sikafloor-3QuartzTopGR-sq-AL-(03-2019)-3-1.pdf